

VENDIM
Nr.735, datë 5.11.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT
RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar t’i shtohet edhe “24 km” rrugë.
2. Në lidhjen 1 “Rrjeti rrugor kombëtar”, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet emërtimi:
“Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Elbasan
Elbasan-Gjinar 24 km rrugë interurbane, dytësore.”.

3. Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale”, që i bashkëlidhet vendimit, hiqet emërtimi “Elbasan-Gjinar”.

Ky vendim hyn në fuqi në 1 janar 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano